



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:065758
Datë: 28.10.2024
Numri i dokumentit: 06360584

SCC-10-0306

Paditësit :

L K,D K dhe V K fshati C Komuna e Prishtinës, përfaqesuar nga **Av. F Sh**, Prishtinë

Kundër

Pala e paditur:

MDD “Ratar” – Laplje Sello, të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga kryesuesja e kolegjit Hajrie Shala gjyqtare dhe anëtarët e kolegjit Bajram Miftari dhe Asllan Krasniqi gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt.28 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Gjykata jep pëlqimin mbi tërheqjen e padisë.**
- 2. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt. 19 tetor 2010 paditësi L K, D K dhe V K, të tre nga f. C, Komuna e Prishtinës të cilët i përfaqëson av. F Sh nga Prishtina kundër të paditurës MDD “Ratar” nga Lapje Sello e cila përfaqësohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë.

Paditësit në padi kanë kërkuar nga gjykata që të aprovet si e bazuar kërkesëpadia dhe të vërtetohet se paditësit janë pronarë të sipërfaqes së tokës e cila në vendin e quajtur “..” e cila evidentohet si pjesë e ngastrës kadastrale nr., me sip. Prej 1501m², që në bazë të Certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr.. ZK Ç., evidentohet në emër të KBI “Kosova – Export” Fushë Kosovë – MDD “Ratar” Lapje Sellë, për shkak se kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prishtinës, me VR.NR.. e dt. ., në mes të Q. K. si paraardhës juridik i paditësve dhe Ndërmarrjes Bujqësore “Laple Sello” në Laplje Sellë, si paraardhës juridik i të paditurës, është anuluar në tërësi me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C.nr.99/94 të dt. 12.06.1995 dhe të detyrohet e paditura MDD “Ratar” nga Lapje Sello, që në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi tua njof të drejtën e pronësisë.

Së bashku me padi ankuesit kanë parashtruar: Kopjen e vendimin P.br.99/94 i dt. 12.06.1995.

Me 24 dhjetor 2010, e paditura AKP ka parashtrua mbrojtjen në padi më të cilën në tërësi e konteston kërkesëpadinë e paditësve. Në shkresat e lëndës të prezantuara nga paditësit, AKP-ja konstaton se lidhur me këtë çështje juridike, procedura kontestimore është filluar në vitin 1994 dhe ka përfunduar në vitin 1995.

Me dt. 11 shkurt 2011, paditësit parashtrojnë përgjigjen në padi me të cilën kërkon nga gjykata që të procedoj më tutje sipas padisë së paraqitur.

Me 25 mars 2011, e paditura paraqet kundërpërgjigjen e saj me të cilën thekson se në tërësi e konteston kërkesëpadinë e paditësve.

Me 03 tetor 2024, gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancë degjimore.

Përfaqësuesi i paditësve në fjalën e tij theksoi se pas konsultimit me paditësin dhe njoftimit nga i njëjti se nuk ka interes për të vazhduar procedurën pasi që prona kontestuese është tjetërsuar sipas një marrëveshjeje, më këtë rast kërkoi të tërhiqet nga padia .

Arsyetimi ligjor

Neni 34.1 i Ligjit për DHPGJS parasheh që, paditësi mund ta tërheq padinë e tij në çdo kohë me pajtimin e DHPGJS. Me dhënien e pëlqimit të saj Gjykata merr parasysh interesin e të gjitha palëve tjera.

Nga kjo gjykata konsideron se Paditësi nuk ka interes për çështjen juridike të tij për faktin se sipas deklaramentit të përfaqësuesit të autorizuar për pronën kontestuese është arritur marrëveshjeje dhe e njëjta është tjetërsuar. Pra mbi këtë bazë u vendos të jepet pëlqimi për tërheqje të padisë.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 34.1 i Ligjit për Dhomës së Posaçme u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore

Duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hajrije Shala Gjyqtare kryesuese _____

Bajram Miftari gjyqtar _____

Asllan Krasniqi gjyqtar _____